

# Ec dhe fol

Përdori këto letra, mund të të ndihmojnë të flasësh me foshnjën ose fëmijën tënd kur ke dalë jashtë shtëpisë, i dhe në zhvillimin e aftësive të tij të të folurit dhe komunikimit.



Në partneritet me

Better  
Health

Start  
for Life

*Shiko, dëgjo dhe bisedo!*

# Shiko, dëgjo dhe bisedo.

Bisedat që bën me fëmijën tënd janë të rëndësishme për të ardhmen e tij.



## A e di se?

Kur ti bisedon me fëmijën tënd përpara se të arrijë të thotë ndonjë fjalë e ndihmon atë të mësojë të flasë.

Përpiqu të bësh një bisedë “murmuritje” me të duke kopjuar tingujt që lëshon!



# Pse?



Pesë vitet e para të jetës së një fëmije kanë një ndikim të madh. Zhvillimi që ndodh ndihmon në përmirësimin e të mësuarit, lumturisë dhe mirëqenies së tij në të ardhmen.

Ti mund ta ndihmosh këtë zhvillim duke gjetur mundësi për të folur me fëmijën, për ta dëgjuar sa më shpesh që të mundesh dhe për t'i paraqitur gjëra të reja.

**Bisedo**

**Dëgjo**

**Shiko**




# Si?

- Lexo letrat për të marrë ide dhe mbaji me vete.
- Ndiq drejtimin e fëmijës tënd (vëre se për çfarë interesohet).
- Çdo bisedë që bën me fëmijën tënd është e rëndësishme



# Ti mund të vësh re dhe të flasësh për...

Gjërat e gjalla, ato që lëvizin, që mund t'i dëgjosh ose nuhatësh, p.sh. moti, shkronjat dhe numrat, mënyra të ndryshme lëvizjeje, modele, tekstura etj.



# Ti mund të

Numërosh

1234

Vësh re gjërat e vogla



Lëvizësh në mënyra të ndryshme



Krijosh një histori ose këngë



Bësh stërkala në një pëllëmbë



Kënpësh një këngë ose ninullë për fëmijë



Luash / Thuash tingullin e parë të një file



Përdorësh shqisat e tua




# Ndiq drejtimin e fëmijës tënd. Fol për gjërat, që ai po bën dhe i ka vënë re.



## A e di se?

Duke i treguar fëmijës tënd se je i/e  
interesuar për atë që bën dhe thotë, rritet  
besimi i tij.





**Ndërmarrja e hapave  
të vegjël të ndihmon  
për të ruajtur  
ekuilibrin.**

**Kur ti më flet për atë  
që po bëj, më mëson  
fjalë të reja  
Kjo është një ide e  
mirë!**




# Kur flet me foshnjën ose fëmijën tënd, jepi kohë të mendojë dhe të përgjigjet.



## **Këshilla praktike:**

Kur i flet atij, prit të paktën 5-15 sekonda që ai të të përgjigjet.





**Më ndihmon nëse  
më jep kohë për të  
menduar**


**Kur pres pak që  
fëmija të përgjigjet,  
ai më jep një  
përgjigje më të mirë**

# Përsëriti tingujt dhe fjalët që thotë fëmija yt dhe shto një ose dy tinguj ose fjalë të tjera.



## A e di se?

Kur ti kopjon atë që thotë fëmija yt, kjo i tregon atij se ti po e dëgjon. Kur thua një ose dy fjalë shtesë, ti i mëson fëmijës fjalë të reja dhe si të thotë fjali më të gjata.





mace

Po, ajo mace e ka  
bishtin me gëzof

da da da, po, mace

dadadada


**Kur ke kohë, gjej një çast,  
ngadalëso shpejtësinë  
dhe tregoji fëmijës se po e  
dëgjon.**



**Këshilla praktike:**

Ndihmoje fëmijën të shikojë më nga afër, të  
vërejë gjërat që mund të shohë ose dëgjojë.





**Kur shoh fytyrën  
tënde ndërsa po  
flasim, më ndihmon të  
mësoj të komunikoj**

**Kur e ngadalësoj  
shpejtësinë dhe i  
kushtoj vëmendje  
të plotë, fëmija  
duket shumë i  
lumtur**


**Mendo për llojin e pyetjeve që  
bën. Pyetjet më të mira janë  
ato që nxitin të menduarit  
dhe jo një përgjigje me një  
fjalë të vetme.**

#### **A e di se?**



S'ka problem nëse nuk mund t'u përgjigjesh të gjitha pyetjeve të fëmijës tënd. Mund të shkosh në bibliotekë ose të përdorësh internetin për të kërkuar përgjigje së bashku.






**Pyes veten se  
ku po shkon ai  
kërmill?**

**Unë mendoj  
se kërmilli po  
shkon...**

**?**





Sa herë që të mundesh, gjatë  
ditës përfshi shikimin, dëgjimin  
dhe bisedën.

Kjo do të ndihmojë në  
të folurit dhe aftësitë  
e komunikimit të  
fëmijës tënd.

**Nëse je i/e shqetësuar për  
zhvillimin gjuhësor të fëmijës  
tënd, mund të flasësh me  
infirmieren e kujdesit në  
shtëpi, Family Hub ose ofruesin  
e kujdesit për fëmijët.**

Në partneritet me